



Bartësi Privat i Arsimit të Lartë

KOLEGJI I SHKENCAVE MJEKËSORE "REZONANCA"
Prishtinë

Nr.ref. 3945-2/20

Datë: 29.09.2020

Në bazë të nenit 106-109 të Statutit të Kolegjit të Shkencave Mjekësore "Rezonanca", Senati në mbledhjen e mbajtur më 28.09.2020 miratoi këtë:

KONKURS

Për pranimin e studentëve të rinj në vitin akademik 2020/2021

Kolegji i Shkencave Mjekësore "Rezonanca" në Prishtinë, në vitin e parë të studimeve, në programet e studimeve Bachelor dhe Master, në vitin akademik 2020/2021, do të regjistrojë studentët në programet e akredituara të paraqitura në tabelën vijuese:

Programet studimore të akredituara	Vendimi për akreditim	Nr. i studentëve
1. Programi Bachelor i Shkencave të Mamisë (180 ECTS)	1366/19D, dt. 29.07.2019	40
2. Programi Bachelor i Shkencave të Infermierisë (180 ECTS)	1366/19D, dt. 29.07.2019	100
3. Programi Bachelor i Shkencave të Biokimisë Laboratorike (180 ECTS)	1366/19D, dt. 29.07.2019	50
4. Programi Bachelor i Shkencave të Radiologjisë Diagnostike (180 ECTS)	1366/19D, dt. 29.07.2019	50
5. Programi Bachelor i Shkencave të Farmacisë Komunitare (180 ECTS)	147/20D. Dt. 11.02.2020	120
6. Programi Bachelor i Shkencave të Fizioterapisë (180 ECTS)	147/20D. Dt. 11.02.2020	120
7. Programi i Stomatologjisë (Dr.Stom, 300 ECTS)	1571/20D, dt. 11.09.2020	60
8. Programi Master i Shkencave të Farmacisë (120 ECTS)	1366/19D, dt. 29.07.2019	50

KUSHTET E KONKURSIONIT

Në konkurs mund të paraqiten kandidatët të cilët i plotësojnë këto kushte:

- të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme të Kosovës, në programet e të cilave kanë dëgjuar së paku një vit Biologji, Kimi dhe Fizikë, me provimin e maturës të kryer, të vërtetuar me Diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme të profesionale mjekësore të Kosovës, me provimin e maturës të kryer, të vërtetuar me Diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme të Kosovës, në programet e të cilave kanë dëgjuar së paku një vit Biologji, Kimi dhe Fizikë, në sistemin pa provim të maturës, të vërtetuar me Diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme të shteteve të tjera (duhet të paraqesin certifikatën dhe diplomën për kryerjen e shkollimit 12-vjeçar, në programet e të cilave kanë dëgjuar së paku një vit Biologji, Kimi dhe Fizikë, të nostifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës);
- të gjithë të graduarit ose të regjistruar në institucione të arsimit të lartë nga lëmenjtë e shkencave mjekësore ose shkencave natyrore

Nëse kandidatët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet për lëndët Biologji, Kimi ose Fizikë sipas pikës një të paraparë në kushtet e konkursit, duhet të kalojë vlerësimin plotësues nga ajo lëndë.

Në programet Master mund të paraqiten kandidatët të cilët i plotësojnë këto kushte:

- kanë të përfunduar nivelin bachelor në programin adekuat të fushës (180 ECTS), të vërtetuar me Diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e nivelit bachelor në programet e fushës të shteteve të tjera (aplikuesit shtetas të Republikës së Kosovës duhet të paraqesin diplomën për kryerjen e nivelit bachelor, të nostifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës)
- absolventët e programit BSc të Farmacisë

Njohja e certifikatave, përkatësisht diplomave të jashtme do të bëhet në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:

- a. Sukses në shkollën e mesme deri në 20 pikë
- b. Sukses në provimin pranues deri në 80 pikë

2. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:

- a. Sukses në shkollën e mesme deri në 20 pikë
- b. Sukses në maturë deri në 50 pikë
- c. Sukses në provimin pranues deri në 30 pikë

Provimi pranues sipas programeve mbahet nga lëndët e paraqitura në tabelën vijuese:

Programi studimor/Programi i studimit	Lëndët në provimin kualifikues
1. Programi Bachelor i Shkencave të Mamisë (180 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë
2. Programi Bachelor i Shkencave të Infermierisë (180 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë
3. Programi Bachelor i Shkencave të Biokimisë Laboratorike (180 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë
4. Programi Bachelor i Shkencave të Radiologjisë Diagnostike (180 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë
5. Programi Bachelor i Shkencave të Farmacisë Komunitare (180 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë, Matematikë
6. Programi Bachelor i Shkencave të Fizioterapisë (180 ECTS)	Biologji, Fizikë
7. Programi i Stomatologjisë (Dr.Stom, 300 ECTS)	Biologji, Kimi, Fizikë

Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi, kanë vetëm kandidatët që arrijnë 20% nga numri i pikëve të parapara për provimin pranues.

Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve është i barabartë, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të përgjithshëm nga shkolla e mesme. Nëse edhe pas kësaj do të kemi të njëjtën dukuri, merret sukses nga lëndët e ngushta profesionale. Nëse edhe pas kësaj kemi të njëjtën dukuri, zgjedhjen e kandidatëve e bën Komisioni për pranimin e studentëve të rinj.

Për funksionimin e programit është i nevojshëm numri minimal prej 10 studentëve. Për raste të veçanta, për programe të caktuara, grupi mund të formohet edhe me më pak studentë, sipas vendimit të Senatit të Kolegjit.

Për studimet Master, kandidatët për regjistrim do të përzgjedhen në bazë të këtyre kritereve:

- a. Sukses gjatë studimeve në nivelin bachelor (nota mesatare e studimeve) = max. 60 pikë

- b. Publikimeve, pjesëmarrjeve në kongrese/konferenca/takime profesionale dhe aktivitet të tjetër kërkimore-shkencore = 10 pikë
- c. Trajnime, kurse të tjera të kryera = 20 pikë
- d. Njohja e Gjuhës Angleze (të dëshmuar me certifikatë/diplomë = 10 pikë

Në provimin pranues kandidatët që nuk kanë dëshmi për njohjen e gjuhës angleze duhet të kalojnë Testin nga Gjuha Angleze, së paku me 75% sukses, si dhe të sjellin certifikatën për njohjen e gjuhës, më së largu deri në fund të vitit të parë të studimeve.

Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve është i barabartë, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit gjatë studimeve bachelor nga lëndët e ngushta profesionale. Nëse edhe pas kësaj kemi të njëjtën dukuri, zgjedhjen e kandidatëve e bën Komisioni për pranimin e studentëve të rinj.

AFATET E KONKURISIT

Paraqitja e dokumenteve fillon nga data **30 gusht 2020**, prej orës **09:00-19:00**.

Për afatin e parë, provimi pranues do të mbahet më **30 shtator 2020**, në orën **10:00**.

Paraqitja e dokumenteve për afatin e dytë të konkursit zgjatë deri më **13 tetor 2020**, kurse provimi pranues për afatin e dytë do të mbahet më **14 tetor 2020**, në orën **10:00**.

Paraqitja e dokumenteve për studimet Master bëhet deri më **09 nëntor 2020**.

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Kolegjin e Shkencave Mjekësore "Rezonanca" (në Veternik).

Për paraqitje në konkurs kandidatët duhet të sjellin:

- *Certifikatën e lindjes*
- *Dëftesat e shkollës së mesme;*
- *Diplomën e shkollës së mesme;*
- *Fletë-aplikacionin (që merret dhe plotësohet në Institucion).*
- *Vendimin për njohjen e shkollimit jashtë vendit (nostifikimi) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.*
- *Kopjen e leternjoftimit*

Për paraqitje në konkurs për studimet Master kandidatët duhet të sjellin:

- *Certifikatën e lindjes.*
- *Diplomën Bachelor (me 180 ECTS).*
- *Suplementin e diplomës.*
- *Fletë-aplikacionin (që merret dhe plotësohet në Institucion).*
- *Vendimin për njohjen e shkollimit jashtë vendit (nostifikimi) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.*
- *Kopjen e leternjoftimit.*
- *Dëshmitë lidhur me publikimet shkencore (kopjet).*
- *Dëshmitë lidhur me trajnimet tjera (certifikatat/diplomat).*
- *Dëshmitë për testin e gjuhës angleze (certifikata/diploma).*

Me rastin e paraqitjes në konkursin për pranim kandidatët paguajnë 15 Euro.

Në të gjitha fazat e procedurës së pranimit kandidatët me vete duhet të sjellin dokumentin e identifikimit.

Kandidatët e pranuar, për regjistrim duhet të paraqesin:

- *Fletë-aplikacionin për regjistrim (i cili merret në Institucion);*
- *Një fotografi të formatit 4.5 x 6 cm;*
- *Fletëpagesën për këstin e parë të pagesës së studimeve.*

Me rastin e regjistrimit kandidatët e nënshkruajnë Kontratën me Kolegjin.

Kandidatët mund të informohen nëpërmjet:

- Informatorit të KSHMR për vitin akademik 2020/2021 (merret në Kolegji)
- Tel. 038-544-754, prej orës 09:00 deri 18:00
- E-mail: info@rezonanca-rks.com
- Web-faqës: www.rezonanca-rks.com